

Spasoje (Živko) Burdžić

(25.05.1937, serb nga Opterusha/Opterusua, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)

Miodrag (Živko) Burdžić

(17.08.1938, serb nga Opterusha/Opterusua, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Në fshatin Opterushë/Opterusua ndodheshin 12 shtëpi serbe dhe mbi 200 shqiptare. Në fillim të muajit korrik të vitit 1998, forcat e UÇK-së i kanë hapur istikamet vetëm një kilometër larg fshatit. Serbët ishin të armatosur. I kishin disa pushka të mira, ndërkaq armatimi tjetër konsistonte vetëm në pushkët gjuetie. Lidhjet telefonike nuk funksiononin. Për ditë dëgjoheshin të shtëna dhe, rrjedhimisht, shumica e serbëve të rinj dhe fëmijët u larguan nga fshati. Kanë mbetur vetëm shtatëmbëdhjetë persona: Mladen Božanić me bashkëshorten Dragicen dhe të birin Nemanjen; nëna e Mladenit, Dobrila; djali i axhës së Mladenit, Božidari me bashkëshorten Dušanken dhe të birin Novicen. Nga familja Burdžić, në fshat ndenjën vëllezërit Spasoje dhe Miodragu, si dhe bashkëshortja e këtij të dytit, Slavka; Milutini me bashkëshorten Stanojken. Po ashtu, nga shtëpitë e veta nuk deshën të largoheshin Spasoje Banzic me bashkëshorten Slavicen dhe të ëmën Desanken, si dhe Sreten Simić me bashkëshorten Olgen. Nga burrat, vetëm Novica dhe Nemanja Božanić e kishin moshën paksa më të re dhe me shëndet më të qëndrueshëm.

Ditën e premte, më 17.07.1998, nga mesdita, në afërsi të fshatit [Opterushë/Opterusua] u dëgjuan krismat. Të gjithë serbët, përpos Milutinit, Stanojkes, Desankes dhe Olges, u strehuan te familja Božanić, në qendër të fshatit. Gratë u fshahën në bodrumin e shtëpisë së re të Mladenit, ndërkaq burrat e armatosur e mbanin rojën. Nga ora 1:00 të pasmesnatës [18.07.1998], pjesëtarë të UÇK-së hapën zjarr mbi shtëpitë serbe. Nemanja u plagos nga predha e minahedhësit, e cila e qëlloi shtëpinë e Boškos. Burrat e kthenin zjarren deri në mëngjes, kur vendosën të dorëzoheshin. Në oborrin e familjes Božanić hyrën afro 40 pjesëtarë të UÇK-së, nga të cilët Mladeni dhe serbë të tjerë i njohën

pesë veta [emrat janë të njohur për FDH]. Së pari, ushtarët u morën burrave të gjitha armët. Më pas, i kontrolluan. Pastaj i çuan me traktorin e Boškos te vreshtat e familjes Božanić, përmbi fshat. Pas pak, te vreshtat u sollën edhe Milutini, Stanojka, Desanka dhe Olga, që kishin mbetur në fshat. Nga vreshtat, i bartën me një kamion të mbuluar me ceradë deri te fshati Semetishtë/Semetište [Suharekë/Suva Reka], ku i futën në një shtëpi shqiptare. Gratë i çuan në katin e dytë të shtëpisë, ndërkaq burrat i mbyllën në bodrum. Gratë dëgjonin me orë të tëra rënkimin e burrave që rriheshin nga ushtarët. Ditën e diel, rreth orës 22:00, ushtarët i çuan Dragicen, Dobrilen, Dušanken, Slavkon, Slavicen, Desanken, Olgen, Stanojken dhe Milutinin e moshëthyer në Zoqishtë/Zočiste.

Ditën e pacaktuar në fund të muajit korrik, burrat nga Opterusha/Opterusua, së bashku me serbët e burgosur nga Retija/Retimlje [të shikohen regjistrimet] dhe të burgosurit e tjerë, u nxorën jashtë burgut të UÇK-së në Malishevë/Mališevo [godina e stacionit policor] dhe u dërguan në drejtim të Prishtinës/Priština. Për një kohë të gjatë, familjarët nuk kishin kurrfarë njohuri për fatin e të burgosurve nga Opterusha/Opterusua. Mbetjet e tyre mortore u zhvarrosën gati tetë vjet më vonë, në muajin prill të vitit 2005, nga varrezat masive në Volljakë/Volujak [Klinë/Klina]. Pas identifikimit me analizën e ADN-së, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur u ka dorëzuar familjarëve mbetjet mortore të Mladenit, Nemanjes, Božidarit, Novices, Sretenit, Spasoje Banzicit dhe Spasoje dhe Miodrag Burdžicit. Dorëzimi është bërë më 13.10.2006 në Merdare. Të gjithë u varrosën një ditë më vonë, më 14.10.2006, në varrezat Orlovaça në Beograd.

Burimet: deklarata K.K, FDH-400; deklarata M.N, FDH-460; deklarata L.K, FDH-583; deklarata O.B, FDH-3900; deklarata V.K, FDH-13527; deklarata Ž.K, FDH-29092; deklarata B.K, FDH-29094; deklarata C.B, FDH-3896; deklarata M.D, FDH-470; deklarata V.V, FDH-3898; deklarata M.B, FDH-3897; deklarata M.K., FDH-18936; deklarata R.Đ, FDH-18937; deklarata D.B, FDH-18939; HRW, *Po naređenju...*, 38, 78, 84, 359; FDH, *Registri i kufomave...*, FDH-12986; AIS, *Zona...*, 64-66, FDH-16913; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu*